

1

**KONTRATË SHITBLERJE  
TË KUOTËS NË KAPITALIN E SHOQËRISË  
“ALADINI TRADE PARTNER”SH.P.K**

**Palët**

**Z.Spiro Naçi**, i biri i Vasilit, shtetas Shqiptar, lindur me 31.03.1997, në Janinë-Greqi, banues në Dropull-Gjirokastrë, mbajtës i letërnjoftimit me ID Nr.033128830, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, që këtu e më poshtë do të quhet **SHITËSI**

dhe

**Subjektit INVG Shpk**, me NIPT L81316018U, adresa në Tiranë, me administrator z.Pandeli Garo, mbajtës i letërnjoftimit nr.033491207 i regjistruar pranë QKB, që këtu e më poshtë do të quhet **BLERËSI**

Referuar bashkërisht si **“Palët”**.

kanë hartuar Kontratën e Shitblerjes të kuotës në Kapitalin e Shoqërisë “Aladini Trade Partner” Sh.p.k datë 06.09.2021, si vijon:

**SHITËSI: Spiro Naçi**, është pronar në shoqërinë “Aladini Trade Partner” sh.p.k, person juridik i së drejtës shqiptare, e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me datë 09.11.2020, me seli: Njesia Bashkiake nr.5, Rruga Sami Frasheri, Zone Kadastrale nr.8270, sip.311 m<sup>2</sup>, nr pasurie 2/510+2, vol 41, faqe 206/207, me numër NIPT: M02311002E, me kapital prej 9.300.000 lekë, që perbëhet nga 5 kuota.

Kapitali i shoqërisë zotërohet nga ortakët :

- Z.Spiro Naçi me 59.2% te kapitalit
- Z.Valer Pinderi me 20% te kapitalit
- Z.Gerti Boshnjaku me 5% te kapitalit
- Z.Julian Lesi me 14.5 % te kapitalit.
- Z.Gjergj Konomi me 1.3% te kapitalit

Njeri nga ortakët e shoqërisë “Aladini Trade Partner” sh.p.k., Z.Spiro Naçi ka kërkuar të shesë 2% të kuotës që zotëron në kapitalin e shoqërisë “Aladini Trade Partner” sh.p.k., tek ortaku i ri INVG Shpk e cila ka shprehur interesin për blerjen e 2 % te kuotës të kapitalit te shoqërisë “Aladini Trade Partner” sh.p.k.

**BLERËSI:** INVG Shpk pranon të blejë nga shitësi ortaku i shoqërisë “Aladini Trade Partner” sh.p.k., prej 2 % të kapitalit, ose me vleftë prej 186,000 (Njëqind e tetëdhjete e gjashtë mijë) lekë nga kapitali që disponon në shoqëri.

Pronësia e shitësit Z.Spiro Naçi për kuotën prej 2% dhe vlerën e kapitalit në shoqëri “Aladini Trade Partner” vërtetohet nga Ekstrati i Qendrës Kombëtare të Regjistrimit datë 06.09.2021.

Nga shit-blerja e kuotës të kapitalit prej 2% të zotëruar nga ortaku ekzistues i shoqërisë Z.Spiro Naçi tek ortaku i ri të shoqërisë, pjesëmarrja në kapital do të jetë:

Z.Spiro Naçi do të zotërojë 57.2 % të kapitalit, ose 1(një) kuotë dhe në vleftë prej 5,319,600 lekë,

Z.Valer Pinderi do të zotërojë 20 % të kapitalit, ose 1(një) kuotë dhe në vleftë prej 1.860.000 lekë,

Z.Gerti Boshnjaku do të zotërojë prej 5 % të kapitalit, ose 1(një) kuotë dhe në vleftë prej 465,000 lekë,

Z.Gjergj Konomi do të zotërojë prej 1.3 % të kapitalit, ose 1(një) kuotë dhe në vleftë prej 120,900 lekë

Z.Julian Lesi do të zotërojë prej 14.5 % të kapitalit, ose 1(një) kuotë dhe në vleftë prej 1,348,500 lekë

INVG Shpk do të zotërojë prej 2 % të kapitalit, ose 1(një) kuotë dhe në vleftë prej 186,000 lekë

Likujdimi i vlerës të kuotës që zotërohet nga ortaku Z.Spiro Naci prej 186,000 leke bëhet nga ana e blerësit.

Në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr.8438, date 28.12.1998“Për Tatimin mbi te Ardhurat“, i ndryshuar, nga shitja e kuotës prej 2 % të kapitalit të shoqërisë “Aladini Trade Partner” nga ortaku Z. Spiro Naçi nuk lind ndonjë detyrim pasi vlera e shitjes të kuotës është e barabartë me vlerën nominale të kuotës.

Kjo kontratë lidhet me vullnetin e lirë të palëve dhe pasi gjëndet e rregullt, firmoset sipas ligjit nga palët.....

## PALËT

SHITËSI

.....  
*Spiro Naçi*

BLERËSI

.....  
*Ramirez*  
  
*RAMIREZ*